

Microsoft License Terms

Përditësimi i fundit: dhjetor 2016

KUSHTET E LICENCËS SË SOFTUERIT TË MICROSOFT-IT

SISTEMI OPERATIV WINDOWS

NËSE JETONI (OSE NËSE KENI SELINË E AKTIVITETIT) NË SHBA, LEXONI KLAUZOLËN DETYRUESE TË ARBITRAZHIT DHE TË HEQJES DORË NGA PADITË KOLEKTIVE NË SEKSIONIN 10. KA TË BËJË ME MËNYRËN E ZGJIDHJES SË MOSMARRËVESHJEVE.

Faleminderit që keni zgjedhur Microsoft-in!

Në varësi të mënyrës se si e keni marrë softuerin Windows, kjo është një marrëveshje licence (i) midis jush dhe prodhuesit të pajisjes ose instaluesit të softuerit që shpërndan softuerin me pajisjen tuaj; ose (ii) midis jush dhe Korporatës Microsoft (ose me një nga filialet e Korporatës Microsoft, në bazë të vendit tuaj të banimit ose të selisë së aktivitetit tuaj) nëse e keni blerë softuerin nga një shitës me pakicë. Microsoft-i është prodhuesi i pajisjes për pajisjet e prodhuara nga Microsoft-i ose nga një prej filialeve të tij, dhe Microsoft-i është shitësi me pakicë nëse e keni blerë softuerin drejtpërdrejtë nga Microsoft-i.

Kjo marrëveshje përshkruan të drejtat tuaja dhe kushtet sipas të cilave mund ta përdorni softuerin Windows. Duhet ta shqyrtoni të gjithë marrëveshjen, duke përfshirë çdo kusht shtesë për licencën që shoqëron softuerin dhe çdo kusht që lidhet me të, sepse të gjitha kushtet janë të rëndësishme dhe të gjitha së bashku përbëjnë këtë marrëveshje që zbatohet për ju. Kushtet përkatëse mund t'i lexoni duke vendosur lidhjen (aka.ms/) në dritaren e shfletuesit.

Duke pranuar këtë marrëveshje ose duke përdorur softuerin, bini dakord me të gjitha këto kushte dhe miratoni transmetimin e informacioneve të caktuara gjatë aktivizimit dhe gjatë përdorimit të softuerit nga ju, sipas deklaratës së privatësisë të përshkruar në seksionin 3. Nëse nuk pranoni dhe nuk pajtoheni me këto kushte, nuk mund ta përdorni softuerin ose veçoritë e tij. Mund të kontaktoni prodhuesin ose instaluesin e pajisjes, ose shitësin me pakicë nëse e keni blerë softuerin direkt tek ai, për të vendosur mbi politikën e kthimit dhe për ta kthyer softuerin ose pajisjen kundrejt rikthimit të shumës sipas asaj politike. Duhet të pajtoheni me atë politikë, sipas së cilës mund t'ju kërkohet të ktheni softuerin me të gjithë pajisjen në të cilën është instaluar, në mënyrë që t'ju rimbursohet shuma, nëse është ky rasti.

1. Pasqyrë e përgjithshme.

a. Zbatueshmëria. Kjo marrëveshje zbatohet për softuerin Windows që është i instaluar në pajisjen tuaj ose që është blerë nga një shitës me pakicë dhe është instaluar aty nga ju, për median në të cilën keni marrë softuerin (nëse ka), për çdo skedar fonti, ikonash, imazhesh ose zëri të përfshirë në softuer si dhe për çdo përditësim, përmirësim, shtesa ose shërbime që janë bërë në softuer, me përjashtim të rasteve kur për to ka kushte të tjera. Kjo aplikohet edhe për aplikacionet e Windows të zhvilluara nga Microsoft që ofrojnë funksione të tilla si posta, kontaktet, muzika dhe fotografitë që përfshihen me Windows dhe janë pjesë e saj. Nëse kjo marrëveshje përmban kushte në lidhje me një veçori ose shërbim që nuk është i disponueshëm në pajisjen tuaj, atëherë këto kushte nuk gjejnë zbatim.

b. Kushte shtesë. Në varësi të kapaciteteve të pajisjes suaj, të mënyrës sesi është e konfiguruar dhe sesi e përdorni, Microsoft-i dhe palë të treta mund të vendosin kushte shtesë mbi përdorimin nga ana juaj të disa veçorive, shërbimeve dhe aplikacioneve. Sigurohuni t'i lexoni.

- (i) Disa aplikacione për Windows ofrojnë pikë hyrjeje ose mbështeten mbi shërbimet e internetit, dhe përdorimi i këtyre shërbimeve ndonjëherë rregullohet nga kushte dhe politika të veçanta privatësie, siç është Marrëveshja për shërbimet e Microsoft-it që gjendet në adresën (aka.ms/msa). Këto kushte dhe politika mund t'i shikoni duke kërkuar te kushtet e përdorimit të shërbimit ose në parametrat e aplikacionit, sipas rastit. Shërbimet mund të mos jenë të disponueshme në të gjitha vendet.
- (ii) Microsoft-i, prodhuesi ose instaluesi mund të përfshijnë aplikacione shtesë, të cilat u nënshtrohen kushteve të veçanta të licencës dhe politikave të veçanta të privatësisë.
- (iii) Softueri përfshin Adobe Flash Player që është i licencuar sipas kushteve nga Adobe Systems Incorporated që i gjeni në (aka.ms/adobeflash). Adobe dhe Flash janë marka të regjistruara ose marka tregtare të Adobe Systems Incorporated në SHBA dhe në shtete të tjera.
- (iv) Softueri mund të përfshijë programe të palëve të treta që ju licencohen në bazë të kësaj marrëveshjeje ose sipas kushteve të vetë atyre palëve. Kushtet e licencës, njoftimet dhe kontributet, nëse ka, për programet e palëve të treta mund t'i shihni te (aka.ms/thirdparty notices).
- (v) Deri në shkallën e përfshirë me Windows, Word, Excel, PowerPoint dhe OneNote janë të licencuara për përdorimin tuaj personal, jotregtar, përveçse kur keni të

drejta tregtare sipas një marrëveshjeje të veçantë.

2. Të drejtat e instalimit dhe të përdorimit.

a. Licenca. Softueri licenohet, nuk shitet. Sipas kësaj marrëveshjeje, ne ju japim të drejtën të instaloni dhe të ekzekutoni një instancë të softuerit në pajisjen tuaj (pajisja e licencuar) për përdorim nga një person i vetëm, për sa kohë që do të pajtoheni me kushtet e kësaj marrëveshjeje. Përditësimi ose përmirësimi nga softuerë joautentikë me softuerë nga Microsoft-i ose burime të autorizuar nuk e bën autentik versionin tuaj fillestar ose versionin e përditësuar/përmirësuar dhe në këtë rast ju nuk keni licencë për të përdorur softuerin.

b.Pajisja. Në këtë marrëveshje, "pajisje" nënkupton një sistem hardueri (qoftë fizik ose virtual) me një pajisje të brendshme ruajtëse që është në gjendje të ekzekutojë softuerin. Particionet e harduerit ose shinat konsiderohen gjithashtu si pajisje.

c.Kufizimet. Prodhuesi ose instaluesi dhe Microsoft-i rezervojnë të gjitha të drejtat (siç janë të drejtat sipas ligjeve për pronësinë intelektuale) që nuk jepen shprehimisht në këtë marrëveshje. Për shembull, kjo licencë nuk ju jep të drejtën dhe ju nuk mundeni:

(i) të përdorni ose virtualizoni veçoritë e softuerit, veçmas;

(ii) të publikoni, kopjoni (përveç kopjeve të lejuara rezervë) ose të jepni me qira softuerin;

(iii) të transferoni softuerin (me përjashtim të rasteve kur lejohet nga kjo marrëveshje);

(iv) të ndryshoni ndonjë kufizim teknik në softuer;

(v) të përdorni softuerin si softuer serveri për hostim tregtar, ta vendosni softuerin në dispozicion për t'u përdorur njëkohësisht nga shumë përdorues në rrjet, të instaloni softuerin në një server dhe të lejoni përdoruesit të hyjnë nga distanca ose të instaloni softuerin në një pajisje për t'u përdorur vetëm nga përdorues në distancë;

(vi) kundërxhinierojë, dekompijojë ose çmontojë softuerin, apo të përpiqet ta bëjë atë, përveçse dhe deri në shkallën që kufizimi pararendës (a) lejohet nga ligji në fuqi; (b) lejohet nga kushtet e licencimit që drejtojnë përdorimin e komponentëve me burim të hapur që mund të jenë të përfshirë me softuerin ose (c) kërkohet për të

korrigjuar ndryshimet në ndonjë bibliotekë të licencuar sipas Licencës së Vogël të Publikut të Përgjithshëm GNU që përfshihen dhe lidhen me softuerin dhe

- (vii) kur përdorni veçori me bazë interneti, nuk mund t'i përdorni në asnjë mënyrë që do të interferonte me përdorimin e tyre nga ndonjë tjetër, ose të përpiqeni të përfitonit qasje në ose të përdorni shërbimin, të dhënat, llogarinë ose rrjetin në mënyrë të paautorizuar.

d. Skenarët shumëpërdorimësh.

- (i) **Versionet e shumëfishta.** Nëse kur keni blerë softuerin jeni pajisur me versione të shumëfishta (siç janë versionet 32-bit dhe 64-bit), ju mund të instaloni dhe të aktivizoni versionet vetëm një nga një.
- (ii) **Lidhjet e shumëfishta ose të bashkuara.** Hardueri ose softueri që përdorni për të shumëfishuar ose bashkuar lidhjet ose për të reduktuar numrin e pajisjeve ose të përdoruesve që kanë qasje në softuer ose që përdorin softuerin, nuk e redukton numrin e licencave që ju duhen. Ju mund ta përdorni këtë harduer ose softuer vetëm nëse keni licencë për secilën instancë të softuerit që po përdorni.
- (iii) **Lidhjet e pajisjeve.** Mund të lejoni deri në 20 pajisje të tjera të kenë qasje në softuerin e instaluar në pajisjen e licencuar, për të përdorur veçoritë e mëposhtme të softuerit: shërbimet e skedarëve, shërbimet e printimit, shërbimet e informacionit të internetit dhe shërbimet e telefonisë dhe të ndarjes së lidhjes së internetit në pajisjen e licencuar. Mund të lejoni çfarëdolloj sasie pajisjesh të kenë qasje në softuer në një pajisje të licencuar për të sinkronizuar të dhënat mes pajisjeve. Ky seksion nuk nënkupton, gjithsesi, që keni të drejtë të instaloni softuerin ose të përdorni funksionin primar të softuerit (përveç veçorive të renditura në këtë seksion) në secilën nga këto pajisje të tjera.
- (iv) **Përdorimi në një mjedis të virtualizuar.** Kjo licencë ju lejon të instaloni vetëm një instancë të softuerit për t'u përdorur në një pajisje, qoftë kjo pajisje fizike ose virtuale. Nëse doni të përdorni softuerin në më tepër se një pajisje virtuale, duhet të merrni një licencë të veçantë për çdo instancë.
- (v) **Qasja në distancë.** Mund të caktoni një përdorues të vetëm, jo më shumë se një herë në 90 ditë, që të përdorë pajisjen e licencuar si përdorues i licencuar. Përdoruesi i licencuar mund të ketë qasje në pajisjen e licencuar nga një pajisje tjetër duke përdorur teknologjitë e qasjes në distancë. Përdorues të tjerë, në çdo moment tjetër, mund të kenë qasje në pajisjen e licencuar nga një pajisje tjetër

duke përdorur teknologjitë e qasjes në distancë, por vetëm në pajisje të licencuara veçmas për ekzekutuar të njëjtin edicion ose një edicion më të lartë të softuerit.

(vi) **Asistenca në distancë.** Mund të përdorni teknologjitë e asistencës në distancë për të ndarë një sesion aktiv pa marrë licencë shtesë për softuerin. Asistenca në distancë i lejon një përdoruesi të lidhet drejtpërdrejtë me kompjuterin e një përdoruesi tjetër, zakonisht për të riparuar problemet.

e.Kopja rezervë. Mund të bëni vetëm një kopje të softuerit për ta pasur rezervë dhe gjithashtu mund ta përdorni kopjen rezervë për të transferuar softuerin nëse është blerë si softuer individual, siç përkthehet në seksionin 4 më poshtë.

3. Privatësia; Miratimi për përdorimin e të dhënave. Privatësia jote është e rëndësishme për ne. Disa nga veçoritë e softuerit dërgojnë ose marrin informacione gjatë përdorimit të këtyre veçorive. Shumë prej këtyre veçorive mund të çaktivizohen në ndërfaqen e përdoruesit ose mund të zgjidhni të mos i përdorni ato. Duke pranuar këtë marrëveshje dhe duke përdorur softuerin ju pranoni që Microsoft-i mund të mbledhë, të përdorë dhe të nxjerrë informacionet, sipas përshkrimit në Deklaratën e privatësisë të Microsoft-it (aka.ms/privacy), dhe siç mund të përkthehet në ndërfaqen e përdoruesit që lidhet me veçoritë e softuerit.

4. Transferimi. Dispozitat e këtij seksioni nuk vlejnë nëse e keni blerë softuerin si konsumator në Gjermani ose në ndonjë prej shteteve të përmendura në këtë faqe (aka.ms/transfer), dhe në këtë rast çdo transferim i softuerit te një palë e tretë dhe e drejta e përdorimit të tij duhet të jetë në përputhje me ligjin e zbatueshëm.

a. Softueri i instaluar paraprakisht në pajisje. Nëse softuerin e keni blerë të parainstaluar në pajisje (dhe gjithashtu nëse keni kryer përditësim nga softueri i parainstaluar në një pajisje), mund ta transferoni licencën për të përdorur softuerin direkt te një përdorues tjetër, vetëm me pajisjen e licencuar. Transferimi duhet të përfshijë softuerin dhe nëse jepet me pajisjen edhe një etiketë të sistemit autentik Windows duke përfshirë kodin e produktit. Përpara çdo transferimi të lejuar, pala tjetër duhet të bjerë dakord që kjo marrëveshje zbatohet për transferimin dhe përdorimin e softuerit.

b. Softueri individual. Nëse softuerin e keni blerë si softuer të pavarur (dhe gjithashtu nëse keni kryer përditësim nga softueri që keni blerë si softuer të pavarur), mund ta transferoni softuerin te pajisje tjetër që ju përket juve. Softuerin mund ta transferoni edhe në një pajisje të zotëruar nga dikush tjetër nëse (i) jeni përdoruesi i parë i licencuar i softuerit dhe (ii) përdoruesi i parë bie dakord me kushtet e kësaj marrëveshjeje. Për të transferuar softuerin mund të përdorni kopjen rezervë që ju kemi lejuar të bëni ose median në të cilën ka ardhur ky softuer. Sa herë që transferoni

softuerin në një pajisje të re duhet ta lëvizni softuerin nga pajisja e mëparshme. Nuk mund ta transferoni softuerin për të ndarë licencat midis pajisjeve.

5. Softueri i autorizuar dhe aktivizimi. Autorizoheni të përdorni këtë softuer vetëm nëse jeni i licencuar siç duhet dhe nëse softueri është i aktivizuar siç duhet me një kod produkti të vërtetë ose me metoda të tjera të autorizuara. Kur lidheni me internetin gjatë përdorimit të softuerit, softueri do të kontaktojë automatikisht me Microsoft ose me partnerin e tij për të kryer aktivizimin për ta shoqëruar atë me një pajisje të caktuar. Softueri mund të aktivizohet edhe manualisht me internet ose telefon. Në secilin rast do të bëhet transmetimi i informacioneve të caktuara dhe mund të zbatohet shërbimi i internetit, telefonisë dhe SMS. Gjatë aktivizimit (ose riaktivizimit që mund të shkaktohet nga ndryshime në përbërësit e pajisjes) softueri mund të përcaktojë që ekzemplari i instaluar i softuerit është i falsifikuar, i licencuar jo në mënyrë të saktë ose përfshin ndryshime të paautorizuara. Nëse aktivizimi dështon, softueri do të përpiqet të vetëriparohet duke zëvendësuar softuerët e dëmtuar të Microsoft me softuerë origjinalë të Microsoft. Mund t'ju vijë mesazhe rikujtuese për marrjen e licencës së duhur për softuerin. Aktivizimi i suksesshëm nuk konfirmon se softueri është origjinal apo me licencën e duhur. Nuk mund ta anashkaloni apo ta shmangni aktivizimin. Si ndihmë për të përcaktuar nëse softueri juaj është origjinal dhe nëse keni licencën e duhur, shihni (aka.ms/genuine). Përditësimi, mbështetja dhe disa shërbime të tjera mund t'u ofrohen vetëm përdoruesve që kanë softuerin autentik të Microsoft-it.

6. Përditësimet. Softueri kontrollon periodikisht për përditësime të sistemit dhe të aplikacioneve, si dhe i shkarkon dhe i instalon ato vetë. Mund të merrni përditësime vetëm nga Microsoft-i ose nga burime të autorizuara, dhe Microsoft-it mund t'i nevojitet të përditësojë sistemin tuaj për t'ju siguruar këto përditësime. Duke pranuar këtë marrëveshje, ju bini dakord të merrni këto lloj përditësimesh automatike pa njoftim të mëtejshëm.

7. Të drejtat për të kaluar në versionin e mëparshëm. Nëse pajisja që keni blerë të një prodhues ose instalues ka një version Professional të sistemit Windows të instaluar paraprakisht në të, ju mund të përdorni ose një version Windows 8.1 Pro ose Windows 7 Professional, por vetëm nëse Microsoft-i ofron mbështetje për këtë version të mëparshëm, siç përcaktohet te (aka.ms/windowslifecycle). Kjo marrëveshje zbatohet edhe për përdorimin e versioneve të mëparshme nga ju. Nëse versioni i mëparshëm përfshin përbërës të ndryshëm, përdorimin i këtyre përbërësve nga ju i nënshtrohet kushteve për këta përbërës të parashikuara në marrëveshjen që shoqëron versionin e mëparshëm. As prodhuesi apo instaluesi dhe as Microsoft-i nuk janë të detyruar t'ju furnizojnë versione të mëparshme. Versionin e mëparshëm duhet ta merrni veçmas dhe për këtë mund të paguani një tarifë. Versionin e mëparshëm mund ta zëvendësoni në çdo kohë me versionin që keni blerë fillimisht.

8. Kufizime gjeografike dhe të eksportit. Nëse përdorimi i softuerit tuaj kufizohet vetëm në një zonë të caktuar gjeografike, atëherë softuerin mund ta aktivizoni vetëm në atë zonë. Gjithashtu duhet të zbatoni të gjitha ligjet dhe rregulloret vendase dhe ndërkombëtare për eksportin, të zbatueshme për softuerin, të cilat përmbajnë kufizime për destinacionet, përdoruesit fundor dhe përdorimin fundor. Për më tepër informacion rreth kufizimeve gjeografike dhe të eksporteve, vizitoni (aka.ms/georestrict) dhe (aka.ms/exporting).

9. Procedurat për mbështetjen dhe rimbursimin.

a. Për softuerin e instaluar paraprakisht në pajisje. Për softuerin në përgjithësi, kontaktoni prodhuesin ose instaluesin e pajisjes për opsione mbështetjeje. Përdorni numrin e mbështetjes ndaj klientit që jepet me softuerin. Për përditësime dhe shtesa që keni marrë drejtpërdrejt nga Microsoft-i, Microsoft-i mund të sigurojë shërbime mbështetëse të kufizuara për softuerin e licencuar në mënyrën e duhur, siç përshkruhet në adresën (aka.ms/mssupport). Nëse kërkon rimbursim, kontaktoni prodhuesin ose instaluesin për t'ju komunikuar politikën e rimbursimit. Duhet të pajtoheni me ato politika, të cilat mund t'u kërkojnë të ktheni softuerin me të gjithë pajisjen në të cilën ai është instaluar, në mënyrë që të rimbursoheni.

b. Për softuerin e blerë nga një shitës me pakicë. Microsoft-i siguron shërbime mbështetëse të kufizuara për softuerin e licencuar në mënyrën e duhur, siç përshkruhet në (aka.ms/mssupport). Nëse e keni blerë softuerin nga një shitës me pakicë dhe po kërkon rimbursim dhe nuk mund ta merrni në vendin ku keni blerë softuerin, kontaktoni Microsoft-in për informacione rreth politikave të Microsoft-it për rimbursimin. Vizitoni (aka.ms/msoffices), ose nëse jeni në Amerikën e Veriut, telefononi (800) MICROSOFT ose vizitoni (aka.ms/nareturns).

10. Arbitrimi detyrues dhe heqja dorë nga paditë kolektive nëse jetoni (ose nëse jeni biznes, keni selinë e aktivitetit) në SHBA.

Shpresojmë të mos kemi kurrë mosmarrëveshje, por në rast se do kemi, bashkërisht biem dakord të përpiqemi për 60 ditë ta zgjidhim atë në rrugë jozyrtare. Nëse kjo nuk arrihet, bashkërisht biem dakord ta **paraqesim individualisht mosmarrëveshjen në arbitrazhin detyrues përpara Shoqatës Amerikane të Arbitrazhit ("AAA") sipas Ligjit federal të arbitrazhit ("FAA") dhe të mos ngremë padi në gjykatë, përpara një trupi gjykues ose një gjyqtari.** Në vend të kësaj, vendimi do të merret nga një arbitrues neutral dhe do të jetë i formës së prerë, përveç një të drejte të kufizuar për të apeluar sipas FAA-së. **Nuk lejohen paditë kolektive, arbitrazhet kolektive, paditë private në dobi të interesit publik apo ndonjë procedim tjetër ku dikush vepron në cilësinë e përfaqësuesit. As kombinimi i**

procedimeve individuale pa miratimin e të gjitha palëve. "Ne," dhe "i/e jona," përfshin Microsoft-in, prodhuesin e pajisjes dhe instaluesin e softuerit.

a. Mosmarrëveshjet e mbuluara - çdo gjë përveç IP-së. Termi "mosmarrëveshje" është sa më i gjerë që është e mundur. Ai përfshin çdo pretendim ose divergjencë mes jush dhe prodhuesit ose instaluesit, ose mes jush dhe Microsoft-it, për softuerin, çmimin e tij ose këtë marrëveshje sipas çdo teorie ligjore, duke përfshirë kontratën, garancinë, shkellen, statutin ose rregulloren, **me përjashtim të mosmarrëveshjeve në lidhje me zbatimin ose vlefshmërinë e të drejtave tuaja të pronësisë intelektuale ose të të licencuarve tuaj, ose të të drejtave tona të pronësisë intelektuale ose të të licencuarve tanë.**

b. Postimi fillimisht i Njoftimit të mosmarrëveshjes. Nëse keni një mosmarrëveshje dhe nëse përfaqësuesit tanë të shërbimit ndaj klientit nuk mund ta zgjidhin atë, dërgoni përmes shërbimit postar amerikan Njoftimin e mosmarrëveshjes te prodhuesi ose instaluesi, në vëmendje të: LEGAL DEPARTMENT. Nëse mosmarrëveshjen e keni me Microsoft-in, dërgojeni atë me postë te Microsoft Corporation, në vëmendje të: LCA ARBITRATION, One Microsoft Way, Redmond, WA 98052-6399. Na tregoni emrin tuaj, adresën dhe mënyrën se si t'ju kontaktojmë, çfarë problemi keni dhe çfarë dëshironi. Formulari gjendet në adresën (aka.ms/disputeform). Të njëjtën gjë do të bëjmë edhe ne, nëse do të kemi një mosmarrëveshje me ju. Nëse mosmarrëveshja nuk zgjidhet brenda 60 ditësh, ju ose ne mund të fillojmë arbitrazhin.

c. Opsioni i gjykatës për pretendime të vogla. Në vend që të dërgoni me postë Njoftimin e mosmarrëveshjes dhe nëse plotësoni kërkesat e gjykatës, mund të na padisni në gjykatën për pretendime të vogla që gjendet në vendbanimin tuaj (ose nëse jeni biznes, në vendin e selisë së aktivitetit tuaj) ose në vendin e selisë së aktivitetit tonë – "King County, Washington USA", nëse mosmarrëveshja juaj është me Microsoft-in. Ne shpresojmë të na dërgoni me postë Njoftimin e mosmarrëveshjes dhe të na jepni 60 ditë kohë për t'u përpjekur ta zgjidhim, por ju nuk jeni të detyruar ta bëni përpara se t'i drejtoheni gjykatës për pretendime të vogla.

d. Procedura e arbitrazhit. AAA do të zhvillojë çdo arbitrazh, sipas Rregullave të saj të arbitrazhit tregtar (por nëse jeni individ dhe e keni softuerin për përdorim personal ose shtëpiak, ose nëse vlera e mosmarrëveshjes është 75 000 \$ ose më pak, pavarësisht nëse jeni apo jo individ ose si i përdorni softuerin, zbatohen Rregullat e arbitrazhit për Klientin). Për më shumë informacion, vizitoni (aka.ms/adr) ose telefononi në numrin 1-800-778-7879. Për të filluar arbitrazhin, depozitoni pranë Shoqatës Amerikane të Arbitrazhit (AAA-American Arbitration Association) formularin që gjendet në adresën (aka.ms/arbitration); dërgoni me postë një kopje të tij te prodhuesi ose instaluesi (ose te Microsoft-i nëse mosmarrëveshja juaj është me Microsoft-in). Në një

mosmarrëveshje që përfshin 25 000 USD ose më pak, çdo seancë dëgjimore do të jetë telefonike përveçse kur arbitruesi gjen shkaqe të vlefshme për të zhvilluar në vend të saj një seancë dëgjimore ku palët duhet të paraqiten personalisht. Seanca dëgjimore me praninë e palëve do të zhvillohet në shtetin e vendbanimit tuaj (ose nëse jeni biznes, në shtetin ku keni selinë e aktivitetit tuaj) ose në shtetin ku ne kemi selinë e aktivitetit tonë - Konteja King, Uashington, nëse mosmarrëveshja juaj është me Microsoft-in. Ju zgjidhni. Arbitruesi mund të vendosë për të njëjtat dëme për ju individualisht ashtu siç do të bënte një gjykatë. Arbitruesi mund të vendosë për zgjidhje shpjeguese ose zgjidhje me vendim gjyqësor për ju individualisht, për të plotësuar pretendimin tuaj individual.

e.Tarifat dhe pagesat e arbitrazhit.

- (i) **Mosmarrëveshjet që përfshijnë 75 000 USD ose më pak.** Prodhuesi ose instaluesi (ose Microsoft-i, nëse mosmarrëveshja juaj është me Microsoft-in) do të rimbursojë menjëherë tarifat tuaja të depozitimit të padisë dhe do të paguajë tarifat dhe shpenzimet e AAA-së dhe arbitruetit. Nëse ju refuzoni ofertën tonë të fundit me shkrim për zgjidhjen, të bërë përpara caktimit të arbitruetit, mosmarrëveshja juaj i nënshtrohet vendimit të arbitruetit (i quajtur "vendimi") dhe nëse arbitruesi në vendimin e tij ju jep më tepër nga çka pasur oferta e fundit me shkrim, prodhuesi ose instaluesi (ose Microsoft-i, nëse mosmarrëveshja juaj është me Microsoft-in) do t'ju: (1) paguajë shumën më të madhe të caktuar në vendim ose 1000 USD; (2) paguajë tarifat e arsyeshme të avokatëve, nëse ka; dhe (3) rimbursojë çdo shpenzim (duke përfshirë tarifat dhe kostot e dëshmisë së ekspertit) të konstatuar në mënyrë të arsyeshme nga avokati juaj për hetimin, përgatitjen dhe ndjekjen e pretendimit tuaj në arbitrazh. Shumat do të përcaktohen nga arbitruesi, me përjashtim të rastit kur ju dhe ne biem dakord bashkërisht për to.
- (ii) **Mosmarrëveshjet që përfshijnë më shumë se 75 000 USD.** Pagesa e tarifave të depozitimit dhe e tarifave dhe shpenzimeve të AAA-së dhe arbitruetit rregullohet nga Rregullat e AAA-së.
- (iii) **Mosmarrëveshjet që përfshijnë çdo shumë.** Nëse filloni një arbitrazh, ne nuk do të kërkojmë tarifat dhe shpenzimet tona për AAA-në ose arbitruetin, ose tarifat e depozitimit të padisë suaj të rimbursuara nga ne, me përjashtim të rasteve kur arbitruesi konstaton se arbitrazhi është i pavlerë ose ka nisur për një qëllim të papërshtatshëm. Nëse arbitrazhin e fillojmë ne, do të paguajmë të gjitha tarifat e depozitimit të padisë dhe tarifat e shpenzimet e AAA-së dhe arbitruetit. Në asnjë arbitrazh nuk do t'ua kërkojmë juve tarifat ose shpenzimet tona për avokatin.

Tarifat dhe shpenzimet nuk llogariten në përcaktimin e shumës që përfshin një mosmarrëveshje.

f. Depozitimi duhet të bëhet brenda një viti. Ju dhe ne duhet të depozitojmë në gjykatën për pretendime të vogla ose në arbitrim (përveç mosmarrëveshjeve të pronës intelektuale - shihni paragrafin 10.a.) brenda një viti nga koha kur mund të depozitohet për herë të parë. Në të kundërt ajo ndalohej përfundimisht.

g. Ndashmëria. Nëse konstatohet se heqja dorë nga paditë kolektive është e paligjshme ose e pazbatueshme për një pjesë ose për të gjithë mosmarrëveshjen, ajo pjesë e mosmarrëveshjes nuk do të ndiqet në arbitrazh por në gjykatë, dhe pjesa tjetër do të ndiqet në arbitrazh. Nëse ndonjë dispozitë tjetër e seksionit 10 konstatohet se është e paligjshme apo e pazbatueshme, ajo dispozitë do të veçohet dhe pjesa e mbetur e seksionit 10 vazhdon të jetë e zbatueshme.

h. Konflikti me rregullat e AAA-së. Kjo marrëveshje mbizotëron në rast konflikti me saj dhe Rregullave të arbitrazhit tregtar të AAA-së ose Rregullave të arbitrazhit për klientin të AAA-së.

i. Microsoft-i si palë ose si palë e tretë përfituese. Nëse Microsoft-i është prodhuesi i pajisjes ose nëse ju e keni blerë softuerin nga një shitës me pakicë, atëherë Microsoft-i është palë në këtë marrëveshje. Në të kundërt, Microsoft-i nuk është palë por është palë e tretë përfituese në marrëveshjen tuaj me prodhuesin ose me instaluesin për të zgjidhur marrëveshjen përmes negociatave jozyrtare dhe arbitrazhit.

11. Ligji rregullues. Ligjet e shtetit ose vendit ku jetoni (ose, nëse është biznes vendi ku ndodhet selia e biznesit) drejtojnë të gjitha pretendimet dhe mosmarrëveshjet në lidhje me softuerin, çmimin ose këtë mosmarrëveshje, duke përfshirë pretendimet për shkeljen e kontratës dhe pretendimet sipas ligjeve për mbrojtjen e konsumatorit, ligjet për konkurrencën e padrejtë, ligjet e garancisë së nënkuptuar, për pasurimin e padrejtë dhe pretendimet për dëme, pavarësisht konfliktit të parimeve të ligjit. Në Shtetet e Bashkuara, FAA drejton të gjitha dispozitat në lidhje me arbitrimin.

12. Të drejtat e konsumatorit, ndryshimet sipas zonave. Kjo marrëveshje parashikon të drejta të caktuara ligjore. Ju mund të keni të drejta të tjera, përfshirë të drejtat e konsumatorit, sipas ligjeve të shtetit ose vendit tuaj. Mund të keni edhe të drejta në lidhje me palën nga e cila keni blerë softuerin. Kjo marrëveshje nuk i ndryshon këto të drejta të tjera nëse ligjet e vendit tuaj nuk e lejojnë një gjë të tillë. Për shembull, nëse keni blerë softuerin në një prej zonave të mëposhtme, ose nëse zbatohen ligjet detyruese të shtetit, atëherë për ju zbatohen dispozitat e mëposhtme:

a. Australi. "Garancia e kufizuar" nënkupton garancinë e shprehur të dhënë nga Microsoft-i, prodhuesi ose instaluesi. Kjo garanci jepet në shtesë të të drejtave dhe zgjidhjeve të tjera ligjore që ju mund të keni sipas ligjit, duke përfshirë të drejtat dhe zgjidhjet tuaja ligjore në përputhje me garancitë statutores sipas Ligjit australian për konsumatorin.

Në këtë seksion, "mallra" nënkupton softuerin për të cilin Microsoft-i, prodhuesi ose instaluesi jep garanci të shprehur. Mallrat tona shoqërohen me garanci që nuk mund të përjashtohen sipas Ligjit australian për konsumatorin. Ju gëzoni të drejtën e zëvendësimit ose rimbursimit për ndonjë avari të madhe dhe të rimbursimit për çdo humbje ose dëmtim të parashikueshëm në mënyrë të arsyeshme. Ju gjithashtu gëzoni të drejtën që t'ju zëvendësohen ose riparohen mallrat që nuk kanë cilësi të pranueshme dhe kur avaria e tyre nuk përbën një avari serioze.

b. Kanada. Mund të ndaloni marrjen e përditësimeve në pajisjen tuaj duke çaktivizuar qasjen në internet. Në momentin që rilidhni internetin, softueri do të rifillojë kërkimin dhe instalimin e përditësimeve.

c. Bashkimi Evropian. Kufizimi për përdorimin akademik në seksionin 13.d(i) më poshtë, nuk zbatohet në juridiksionet e përmendura në këtë faqe: (aka.ms/academicuse).

d. Gjermani dhe Austri.

(i) **Garancia.** Softueri i licencuar siç duhet do të funksionojë kryesisht siç përshkruhet në materialet e Microsoft-it që shoqërojnë softuerin. Gjithsesi, prodhuesi ose instaluesi dhe Microsoft-i nuk japin asnjë garanci kontraktuale në lidhje me softuerin e licencuar.

(ii) **Kufizimi i përgjegjësisë.** Në rast shkeljeje të qëllimshme, pakujdesie të rëndë, pretendimesh në bazë të Ligjit për përgjegjësinë për produktin, si dhe në rast vdekjeje ose lëndimi fizik ose personal, prodhuesi, instaluesi ose Microsoft-i mban përgjegjësi sipas ligjit.

Për sa më sipër, prodhuesi, instaluesi ose Microsoft-i do të mbajnë përgjegjësi vetëm për pakujdesinë e lehtë nëse prodhuesi, instaluesi ose Microsoft-i ka shkelur këto detyrime kontraktuale të konsiderueshme, përmbushja e të cilave lehtëson realizimin e duhur të kësaj marrëveshjeje, shkelja e të cilave do të rrezikonte qëllimin e kësaj marrëveshjeje dhe pajtueshmërinë tek e cila një palë mund të ketë besim të vazhdueshëm (të ashtuquajturat "detyrimet thelbësore"). Prodhuesi, instaluesi ose Microsoft-i nuk mbajnë përgjegjësi për raste të tjera të pakujdesisë së lehtë.

e. Rajonet e tjera. Vizitoni (aka.ms/variatiions) për listën aktuale të ndryshimeve sipas zonave.

13. Njoftimet shitesë.

a. Përdorimi i rrjeteve, të dhënave dhe internetit. Për disa veçori të softuerit dhe të shërbimeve të hapura nëpërmjet softuerit, mund të nevojitet qasja e pajisjes suaj në internet. Përdorimi dhe qasja nga ju (duke përfshirë tarifat) mund t'u nënshtrohet kushteve të celularit tuaj ose të marrëveshjes suaj me ofruesin e internetit. Veçori të caktuara të softuerit mund t'ju ndihmojnë të keni qasje më efektive në internet, por llogaritjet e përdorimit të softuerit mund të jenë të ndryshme nga matjet e ofruesit tuaj të shërbimit. Ju mbeten gjithmonë përgjegjës (i) për të kuptuar dhe për t'u pajtuar me kushtet e planeve tuaja dhe të marrëveshjeve, dhe (ii) për çdo çështje që lind nga përdorimi ose qasja në rrjete, duke përfshirë rrjetet e hapura/publike. Mund ta përdorni softuerin për t'u lidhur me rrjetet dhe për të ndarë informacionin e qasjes rreth këtyre rrjeteve, vetëm nëse keni lejen për ta bërë këtë.

b. Standardet vizuale H.264/AVC dhe MPEG-4 dhe standardet e videos VC-1. Softueri mund të përfshijë teknologjinë e dekodimit H.264/MPEG-4 AVC dhe/ose VC-1. MPEG LA, L.L.C. kërkon këtë njoftim:

KY PRODUKT LICENCOHET SIPAS LICENCEVE TË PORTOFOLIT TË PATENTAVE PAMORE AVC, VC-1 DHE MPEG-4, PJESA E 2-të, PËR PËRDORIMIN PERSONAL DHE JOTREGTAR TË NJË KONSUMATORI PËR (i) ENKODIMIN E VIDEOS NË PËRPUTHJE ME STANDARDET E MËSIPËRME ("STANDARDET E VIDEOS") DHE/OSE (ii) DEKODIMIN E VIDEOS AVC, VC-1 DHE MPEG-4, PJESA E 2-të, QË ËSHTË ENKODUAR NGA NJË KONSUMATOR QË MERRET ME NJË AKTIVITET PERSONAL DHE JOTREGTAR DHE/OSE ËSHTË MARRË NGA NJË OFRUES VIDEOSH I LICENCUAR PËR TË OFRUAR VIDEO TË TILLA. ASNJË LICENCË NUK JEPET OSE NUK DO TË NËNKUPTOHET PËR NDONJË PËRDORIM TJETËR. INFORMACIONI SHITESË MUND TË MERRET NGA MPEG LA, L.L.C. VIZITONI (AKA.MS/MPEGLA).

c. Mbrojtja nga softuerët keqdashës. Microsoft-i kujdeset për mbrojtjen e pajisjes suaj nga softuerët keqdashës. Softueri aktivizon mbrojtjen nga softuerët keqdashës, nëse nuk ka mbrojtje të tjera të instaluar ose nëse këto mbrojtje kanë skaduar. Që të bëhet kjo do të çaktivizohen ose mund të hiqen softuerët e tjerë antikeqdashës.

d. Versionet me të drejtatë kufizuar. Nëse versioni i softuerit që keni blerë është i shënuar ose i synuar për një përdorim specifik ose për një përdorim të kufizuar, atëherë

mund ta përdorni vetëm sipas specifikimit. Nuk mund t'i përdorni këto versione të softuerit për veprimtari tregtare, jofitimprurëse ose fitimprurëse.

- (i) **Akademik.** Ju duhet të jeni student, fakultet ose staf i një institucioni arsimor në momentin e blerjes së softuerit për përdorim akademik.
- (ii) **Vlerësimi.** Një softuer për qëllime vlerësimi (testimi ose demonstrimi) ju nuk mund ta shisni, nuk mund ta përdorni në një mjedis operativ funksional apo ta përdorni atë pas periudhës së vlerësimit. Pavarësisht gjithfarë bie ndesh me këtë marrëveshje, **softueri për vlerësim jepet "SIÇ ËSHTË" dhe nuk vlen asnjë garanci, e nënkuptuar apo e shprehur (duke përfshirë garancinë e kufizuar), për këto versione.**
- (iii) **Jo për rishitje.** Ju nuk mund ta shisni softuerin që ka shënimin "Jo për rishitje" ("NFR" ose "Not for Resale").
- (iv) **Versionet paraprake.** Mund të zgjidhni të përdorni versione për shqyrtim, të brendshme, beta apo të tjera të natyrës paraprake të softuerit (këtu "versione paraprake") që "Microsoft" mund t'i vërë në dispozicion. Versionet paraprake mund t'i përdorni deri në datën e skadimit të softuerit dhe për sa kohë që pajtoheni me të gjitha kushtet e kësaj marrëveshjeje. Versionet paraprake janë eksperimentale dhe mund të jenë në thelb të ndryshme nga versioni i qarkulluar në treg. Pavarësisht gjithfarë bie ndesh me këtë marrëveshje, **versionet paraprake jepen "SIÇ JANË" dhe nuk vlen asnjë garanci, e nënkuptuar apo e shprehur (duke përfshirë garancinë e kufizuar), për këto versione. Me instalimin e versioneve paraprake në pajisjen tuaj, mund të zhvlerësoni apo cenoni garancinë e pajisjes dhe mund të mos keni më të drejtë të përfitoni mbështetje teknike nga prodhuesi i pajisjes apo operatori juaj i rrjeti, sipas rastit.** "Microsoft" nuk mban përgjegjësi për dëme që mund të pësoni për pasojë. "Microsoft" mund të mos ofrojë shërbime mbështetjeje për versionet paraprake. Nëse i dërgoni "Microsoft" komente, sugjerime apo përshtypje të tjera rreth versioneve paraprake (këtu "dorëzimet"), njëherësh i jepni "Microsoft" dhe partnerëve të saj, të drejtat që ta përdorin dorëzimin në çfarëdo forme dhe për çfarëdo qëllimi.

14. Marrëveshja e plotë. Kjo marrëveshje (së bashku me çdo material të shkruar ku jepen kushtet e licencës ose së bashku me kushte të tjera që shoqërojnë çdo shtesë, përditësim dhe shërbime të softuerit, që sigurohen nga prodhuesi, instaluesi ose Microsoft-i dhe që përdoren nga ju), si dhe kushtet që jepen në lidhjet e uebit të renditura në këtë marrëveshje, përbëjnë marrëveshjen e plotë për softuerin dhe për çdo shtesë, përditësim dhe shërbim të

tillë (me përjashtim të rasteve kur prodhuesi, instaluesi ose Microsoft-i parashikojnë kushte të tjera për këto shtesa, përditësime dhe shërbime). Këtë marrëveshje mund ta shqyrtoni pasi softueri është ekzekutuar duke vizituar (aka.ms/useterms) ose duke shkuar te Parametrat - Sistemi - Rreth, brenda vetë softuerit. Kushtet mund t'i shqyrtoni në secilën nga lidhjet në këtë marrëveshje, duke shtypur URL-të në shiritin e adresës së shfletuesit dhe duke rënë dakord për ta bërë këtë. Përpara se të përdorni softuerin ose shërbimet, duke përfshirë kushtet e lidhura, ju bini dakord se do të lexoni kushtet. Ju kuptoni se duke përdorur softuerin dhe shërbimet, ju miratoni këtë marrëveshje dhe kushtet e lidhura. Në këtë marrëveshje gjenden edhe lidhje informuese. Lidhjet që përmbajnë njoftime dhe kushte detyruese janë:

- Deklarata e privatësisë së Microsoft (aka.ms/privacy)
- Marrëveshja për shërbimet e Microsoft-it (aka.ms/msa)
- Kushtet e licencës së Adobe Flash Player (aka.ms/adobeflash)

ASNJË GARANCI

SOFTUERI NË PAJISJEN TUAJ (DUKE PËRFSHIRË APLIKACIONET) LICENCOHET "SIÇ ËSHTË". DERI NË MASËN MAKSIMALE TË LEJUAR NGA LEGJISLACIONI VENDAS, JU MERRNI PËRSIPËR TË GJITHË RREZIKUN LIDHUR ME PERFORMANCËN DHE CILËSINË E SOFTUERIT. NËSE SOFTUERI REZULTON ME DEFEKT, JU MERRNI PËRSIPËR TË GJITHË KOSTON E SHËRBIMIT OSE TË RIPARIMIT. AS PRODHUESI I PAJISJES DHE AS MICROSOFT-I NUK JEP ASNJË GARANCI TË SHPREHUR OSE KUSHTE TË TJERA PËR SOFTUERIN. DERI NË MASËN MAKSIMALE TË LEJUAR NGA LIGJET E VENDIT TUAJ, PRODHUESI DHE MICROSOFT-I I PËRJASHTOJNË KUSHTET DHE GARANCITË E NËNKUPTUARA, DUKE PËRFSHIRË ATO TË TREGTUESHMËRISË, CILËSISË, PËRSHTATSHMËRISË PËR NJË QËLLIM TË CAKTUAR DHE TË MOSSHKELJES. MUND TË KENI TË DREJTA SHITESË SI KONSUMATOR OSE GARANCI STATUTORE SIPAS LIGJEVE TË VENDIT TUAJ, TË CILAT KËTO KUSHTE NUK MUND T'I NDRYSHOJNË.

NËSE LIGJET E VENDIT TUAJ IMPONOJNË NJË GARANCI OSE KUSHT EDHE NËSE KJO MARRËVESHJE NUK E PARASHIKON, AFATI I SAJ KUFIZOHET NË 90 DITË NGA DITA QË PËRDORUESI I PARË BLEN SOFTUERIN. NËSE PRODHUESI OSE MICROSOFT-I E SHKEL KËTË GARANCI OSE KUSHT, ZHDËMTIMI JUAJ I VETËM, SIPAS ZGJEDHJES SË PRODHUESIT OSE TË MICROSOFT-IT, ËSHTË (I) RIPARIMI OSE ZËVENDESIMI I SOFTUERIT PA PAGESË, OSE (II) RIKTHIMI I SOFTUERIT (OSE SIPAS ZGJEDHJES SË TIJ, I PAJISJES NË TË CILËN ËSHTË INSTALUAR SOFTUERI) SI

RIMBURSIM PËR SHUMËN E PAGUAR, NËSE KA. KËTO JANË ZHDËMTIMET E VETME PËR SHKELJEN E NJË GARANCIE APO KUSHTI QË MUND TË IMPONOJNË LIGJET E VENDIT TUAJ.

DERI NË MASËN QË NUK NDALOHET NGA LIGJET E VENDIT TUAJ, NËSE KENI NDONJË BAZË PËR RIKUPERIMIN E DËMEVE, JU MUND TË RIKUPERONI NGA PRODHUESI OSE MICROSOFT-I VETËM DËMET E DREJTPËRDREJTA DERI NË SHUMËN E PAGUAR PËR SOFTUERIN (OSE DERI NË 50 DOLLARË AMERIKANË NËSE E KENI MARRË SOFTUERIN FALAS). JU NUK MUND TË KËRKONI DHE HIQNI DORË NGA TË DREJTAT PËR TË KËRKUAR RIKUPERIMIN E DËMEVE OSE ZHDËMTIME TË TJERA, DUKE PËRFSHIRË HUMBJET E FITIMEVE DHE DËMET E DREJTPËRDREJTA, SHKAKËSORE, TË VEÇANTA, TË TËRTHORTA OSE TË RASTËSISHME, BAZUAR NË NJË PJESË TË KËSAJ MARRËVESHJEJE OSE SIPAS ÇDO TEORIE. KY KUFIZIM ZBATOHEK (I) PËR ÇDO GJË QË LIDHET ME KËTË MARRËVESHJE, SOFTUERIN (PËRFSHIRË APLIKACIONET), PAJISJEN, SHËRBIMET, DËMTIMIN OSE HUMBJEN E TË DHËNAVE, PAMUNDËSINË PËR TË TRANSMETUAR OSE PËR TË MARRË TË DHËNA, PËRMBAJTJEN (DUKE PËRFSHIRË KODIN) NË FAQET E INTERNETIT OSE PROGRAMET E PALËVE TË TRETA, DHE PËR (II) PRETENDIMET PËR SHKELJEN E KONTRATËS, GARANCISË OSE TË KUSHTIT; PËRGJEGJËSINË E DREJTPËRDREJTË, NEGLIZHENCËN OSE NDONJË SHKELJE TJETËR; SHKELJEN E NJË STATUTI OSE RREGULLOREJE; PASURIMIN E PADREJTË; OSE SIPAS NDONJË TEORIE TJETËR.

PËRJASHTIMET E DËMEVE DHE KUFIZIMET E ZHDËMTIMIT NË KËTË MARRËVESHJE ZBATOHEN EDHE NËSE NUK PËRFITONI ASNJË ZHDËMTIM (SOFTUERI LICENCOHET “SIÇ ËSHTË”), NËSE RIPARIMI, ZËVENDËSIMI OSE RIMBURSIMI (NËSE KËRKOHEK NGA LIGJI I VENDIT TUAJ) NUK JU KOMPENSON PLOTËSISHT PËR HUMBJET, NËSE PRODHUESI OSE MICROSOFT-I E DINTE OSE DUHEJ TË KISHTE DIJENI PËR MUNDËSINË E DËMEVE, OSE NËSE ZGJIDHJA LIGJORE NUK E PËRMBUSH QËLLIMIN E SAJ THELBËSOR.

Verifikoni me prodhuesin e pajisjes për të përcaktuar nëse pajisja juaj mbulohet nga garancia.